

Muhamed Jashari, MA¹

UDC:
323.273(569.1)

**LUFTA CIVILE NDËRMJET KËNDVËSHTRIMIT REALIST DHE
KONSTRUKTIVIZMIT SOCIAL: Siria si studim rasti**

**ГРАЃАНСКАТА ВОЈНА ПОМЕЃУ РЕАЛИСТИЧКАТА ГЛЕДНА
ТОЧКА И СОЦИАЛНИОТ КОНСТРУКТИВИЗАМ:
Сирија како студија на случај**

**THE CIVIL WAR BETWEEN REALISM AND SOCIAL
CONSTRUCTIVISM POINT OF VIEW: Syria as a case study**

Abstract

The humanitarian tragedy in Syria should serve as a clear testimony to the consequences of man's hunger for domination and power. The desire for domination often determines one's course of action in politics whereby departing from the rational he goes as far as to create disastrous situations for humanity. The world has seen such examples in the past and it is seeing them now in the 21-st century. The researchers of international relations may approach wars and conflicts from different viewpoints and draw the lessons and theories from facts. The *realist* theory or *realpolitik* derives from a pessimistic and unchanging view of politics, in the national and international context. For many scholars it remains the dominant theory of international relations.

In this paper we will try to elaborate the Syrian civil war, which brought about a humanitarian disaster, from two theoretical viewpoints, the *realistic* and *constructivist* ones. The later is considered to be

¹ Publishing House Logos-A. Researcher on International Relations.
(muhammed_j88@hotmail.com)

relatively new in the discourse of world political thinking. Although constructivism is mainly a theory of social sciences, no doubt it is also valid in the field of international relations.

Key Word: *Realism, Power, balance of power, State&non-state actors, Constructivism, Social construct.*

Hyrje

Mendimi tradicional realist duke analizuar zhvillimet dhe marrëdhëniet ndërmjet shteteve zakonisht fokus kryesor ka *fuqinë, interesin nacional, sigurinë* etj. Sipas kësaj paradigme edhe formimi i organizatave ndërkombëtare që kanë për qëllim ruajtjen e paqes dhe sigurisë nuk mund të jetësojnë synimet e tyre vetvetiu, por nevojitet autorizim dhe vullnet nga ana shteteve anëtare. Shtetet si aktorë të sistemit ndërkombëtar, shpeshherë për hir të sovranitetit dhe interesit nacional viktimizojnë atë që është e drejtë.

Po nga ky këndvështrim, duke parë rolin dhe qëndrimin e aktorëve në luftën e Sirisë, mund të thuhet se *realizmi*, mbetet prezent në realitetet aktuale të Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Mirëpo, lufta siriane – tragjedia e madhe e këtij shekulli (*António Guterres:2013*)- shpërtheu si rezultat i shtypjes së protestave dhe revoltës sociale në kontekst të asaj që bota e njohu si *Pranvera Arabe*.

Kjo revoltë ishte fenomen i frymëzuar nga idetë për demokraci, liri të shprehjes, pjesëmarrje në politikë etj., ide këto të cilët u përhapën tek popujt e rajonit falë ndërveprimit social.

Në kuadër të studimeve të Marrëdhënieve Ndërkombëtare ofrohet mundësia që zhvillimeve politike globale, t'i qasemi nga këndvështrimet e ndryshme teorike. Shikuar nga kjo perspektivë, pikërisht shkolla konstruktiviste është ajo e cila sfidoi teorinë e mendimit politik realist.

Nëse këta të fundit vënë theks te *forcat materiale*, konstruktivistët rendin global si dhe marrëdhëniet ndërmjet aktorëve i shohin si një *strukturë shoqërore*, të përqendruar tek *idetë, normat, identiteti* dhe roli i tij në formimin e veprimit politik. Për ata, aspekti më i rëndësishëm i Marrëdhënieve Ndërkombëtare është ai social.

Në bazë të dy paradigmave të Marrëdhënieve Ndërkombëtare *realiste* në njërën anë dhe *konstruktiviste* në anën tjetër, objekt studimi i yni në këtë studim është elaborimi i luftës në Siri.

PIKËPAMJA REALISTE NDAJ LUFTËS CIVILE

Realizmi, ndryshe e njohur si *Politika e fuqisë* ose *Realpolitika* konsiderohet shkolla më e vjetër e mendimit politik ndërkombëtar. Ky term aplikohet në disiplina të ndryshme shkencore. Në shkollën filozofike realizmi është një teori ontologjike që i kundërvihet idealizmit. Në letërsi ajo është kundërshtuese e romanticizmit. Kurse në studimet e Marrëdhënieve Ndërkombëtare realizmi është traditë e analizës që thekson nevojën e shtetit për të ndjekë politikën e fuqisë dhe interesin nacional. (Donnelly, 2005: 29).

Në mendimin realist, politika në esencë është fuqi. Fuqia mund të nënkuptohet ushtrim i ndikimit mbi aktorët e tjerë, ose si diçka që shtetet e posedojnë. (Heywood, 2014:217). Në terme praktike sipas protagonistëve të realizmit, ajo definohet në aspekt të forcës ekonomike dhe fuqisë ushtarake.

Realizmi jo vetëm që nxjerr në pah rolin e sovranitetit të shtetit-komb në nivel të politikës botërore, por shpjegon arsyet se pse ata, (pra shtetet) i kushtojnë rëndësi sovranitetit territorial në Marrëdhëniet Ndërkombëtare. Sipas shkollës realiste ky princip, i cili daton që nga Traktati i Westafalisë (1648), iu jep të drejtë udhëheqësve të shteteve sovrane lirinë dhe përgjegjësinë e të vepruarit gjithçka që është e nevojshme në avancimin e interesit nacional dhe mbijetesën e shtetit. (Amaragbu, 2015: 797-798). Ndryshe kjo është e njohur si supozimi *shtetcentrik* i realizmit, përmes së cilës kur rendin global e karakterizon mungesa e një qeverie qendrore (*anarkia*), shteti përveç autoritetit të tij refuzon të njoh ndonjë fuqi tjetër më të lartë. (Dunne & Schmidt, 2011: 87). Sikurse politikat e brendshme ashtu edhe politikat ndërkombëtare janë luftëra për pushtet. (Morgenthau, 1948:17).

Si doktrinë e politikës ndërkombëtare, realizmi tradicionalisht ka të bëjë me raportet e mbështetura në fuqi ndërmjet shteteve, mirëpo, lufta për të arritur dhe ruajtur pushtetin, për të vendosur rendin dhe drejtësinë brenda shteteve, mund të jetë më e përgjakshme sesa luftërat ndërmjet tyre. (Waltz, 1979:103).

Vlen të theksohet se në vitin 2016 në botë ishin aktivë 49 konflikte, prej tyre vetëm dy ishin ndërmjet shteteve², kurse tjerat brenda tyre. (SIPRI, 2017:2). Një tjetër aspekt që i vështirëson edhe më shumë konfliktet është rritja e *“luftërave të internacionalizuara civile”*. Kjo

² (Indi-Pakistan dhe Eritre-Etiopi)

vjen në shprehje atëherë kur në konfliktin e armatosur ndërmjet qeverisë së shtetit dhe një grupi *-ose grupeve-* opozitare, ndërhyjnë shtetet tjera në njërën apo të dyja palët. (Themnér, 2016:9)

Në vitin 1991, 4% e konflikteve ishin të internacionalizuar sipas definicionit të mësipërm, kurse në vitin 2015, ky numër arriti shifrën deri në 40%. (Einsiedel, 2017:5). Shtetet gjatë luftës civile janë të prekshme ndaj ndikimeve dhe sulmeve të jashtme. (Bound, 2013:10).

Kur autoriteti sovran i shtetit bie, sipas realistëve luftërat e brendshme apo luftërat civile - pra, veprimi ushtarak brenda shtetit, me rezistencë aktive nga të dyja palët - ndodhin për të njëjtat arsye që ndodhin luftërat ndërmjet shteteve. Humbja e autoritetit legjitim për të sunduar sjell prishjen e dikotomisë ndërmjet rendit të brendshëm dhe kaosit ndërkombëtar. (Dunne & Schmidt, 2011: 88).

Në këtë situatë me humbjen e legjitimitetit të qeverisë qendrore, tanimë njerëzit fillojnë ta kthejnë lirinë që ia kishin dhënë pushtetit qendror për hir të sigurisë. Ata (njerëzit) gjejnë një grup me të cilin ndajnë disa vlera ose ideologji të përbashkëta, dhe më këtë shteti ndahet ndërmjet grupeve të ndryshme në linja etnike, fetare ose politike.

Qeveria është e prirë që të paragjykojë dhe përmes propagandës zyrtare portretizon grupet opozitare si “elementë kriminalë”, “elementë të huaj” ose “terroristë”. Në anën tjetër, grupet opozitare e paraqesin qeverinë si jodemokratike, autoritare dhe sidomos paragjykojnë një rajon, etni, ose religjion të caktuar. (Regehr, 2015).

Lufta civile në Siri u bë dëshmi e qartë e involvimit të shumë grupeve opozitare të cilët jo vetëm që luftonin kundër pushtetit qendror, por që ishin në konkurrencë permanente me njëri tjetrin, ndërsa kyçja e aktorëve rajonal e global e internacionalizoi luftën!

Kjo ecuri pa dyshim se tej mase e vështirëson një luftë, si dhe minon mundësitë për vendosjen e paqes.

AKTORËT, INTERESI NACIONAL DHE EKUILIBRI I FORCAVE

Që nga shpërthimi i kryengritjes, aktorët rajonal e global me vigjilencë ndoqën zhvillimet në Siri. Për aktorët e ndryshëm qoftë shtetëror apo joshtetëror, Siria u shndërrua në arenën e konkurrencës strategjike. Për Rusinë, mbështetësin kyç të regjimit, Siria ka qenë prioritet i lartë në politikën e jashtme të saj viteve të fundit. Prioritet i Rusisë gjithmonë ka qenë rivendosja e kapaciteteve ushtarake dhe

politike për Asadin. Andaj, çdo kërcënim për Damaskun është kërcënim i tërthortë për Rusinë dhe interesat e saja. (Söderlund, 2017).

Në botëvështrimin rus, Siria përfaqëson një pjesë të betejës kundër sistemit të sigurisë që mori formë në fund të Luftës së Ftohtë. Qëllimi i Ruisë (nën Presidentin Putin) është krijimi i një sistemi të ri të sigurisë që kufizon institucionet perëndimore dhe fuqinë e SHBA-së në shek. XXI, si dhe të reduktojë rolin amerikan në marrëveshjet kyçe të sigurisë rajonale dhe sistemin global në tërësi. (Covington, 2015:2)

Që nga muajt e parë të konfliktit Rusia i erdhi në ndihmë regjimit sirian nëpërmjet këshilltarëve ushtarak dhe furnizimit me armë, gjithashtu veprimi si mbrojtëse e Sirisë në Këshill të Sigurimit (KS) të OKB-së, përmes mekanizmit të *veto*-s duke parandaluar miratimin e rezolutave që i hapin rrugë intervenimit eventual ushtarak kundër regjimit. (Schmidt, 2017).

Pretenduesit e shkollës së mendimit realist pohojnë se organizatat ndërkombëtare siç janë OKB-ja etj., nuk janë aktor shtetëror, shtetet e fuqishme i ruajnë këto organizata dhe i përdorin për të rritur prestigjin e tyre ndërkombëtar. Realistët vënë në dukje se organizatat ndërkombëtare sikurse marrëveshjet ndërkombëtare, janë instrument të shteteve dhe si të tilla nuk kanë gjasa të zhvillojnë politika autonome. (Collins, White, 2011:93).

Klauzola e përdorimit të *veto*-s simbolizon një kompromis ndërmjet interesave nacionale dhe globale. Ajo siguron që organizata nuk do të ndërtojë një interes global në konflikt me interesin nacional të ndonjërit nga 5 shtetet anëtarë të përhershëm në KS. Pra *veto*-ja është një instrument pajtues i projektuar për të siguruar që çdo interes global i krijuar nga OKB-ja është në harmoni me interesat e përbashkëta të këtyre pesë shteteve. Kjo jep të kuptohet që *veto*-ja shfaq realitetet e fuqisë së botës politike ndërkombëtare. (Thakur, 2006:307).

Qoftë në planin diplomatik po edhe atë ushtarak qeveria siriane pas vetes kishte një aktor të rëndësishëm global. Ndërhyrja e drejtpërdrejtë ushtarake ruse³ në shtator të vitit 2015, njëherit ndërhyrja e parë që nga viti 1979 në Afganistan, rishpalli praninë ushtarake përtej kufijve të ish-bashkimit Sovjetik, me këtë, duke e vendosur Rusinë si një aktor kyç në Lindjen e Mesme.

Përmes ndërhyrjes, Rusia jo vetëm që riktheu qëndrueshmërinë e Asadit dhe siguroi bazat e saja ushtarake, ajo i tregoi rajonit, botës dhe

³ Ndërhyrja ushtarake ruse erdhi si pasojë e kërkesës së regjimit të presidentit Asad.

qytetarëve të saj, se Rusia edhe më tej mbetet një komb i fuqishëm në skenën botërore. (Hooker, 2016:227). Siria konsiderohet vendi i vetëm në Lindjen e Mesme që Rusia posedon influencë të drejtpërdrejtë, ndërsa bazat në Tartus dhe Ladhikije ia mundësojnë daljen në Mesdhe.

Parë nga perspektiva realiste, veprimet e Rusisë viteve të fundit jo vetëm në Siri por gjithandej në Lindjen e Mesme mund të lexohen nën thjerrëzën e ekuilibrit të fuqisë, e cila synon të kundërshtojë ndikimin e SHBA-së në rajon. Ekuilibri i ndikimit të Uashingtonit është mënyra e vetme për Rusinë me qëllim të shmangies së përjashtimit nga zona.

Teoricienti realist John Mearsheimer kur flet për luftën civile siriane dhe qëndrimin e SHBA-së ndaj saj, nisat nga premisat bazë të realizmit, pra interesit nacional, dhe sigurisë si dhe impakti që këto mund të kenë për SHBA-të. Ai pohon se, jo të gjitha vendet e Lindjes së Mesme kanë rëndësi strategjike për SHBA-në, ndërsa Siria nuk përbën një kërcënim serioz për atdheun amerikan, madje edhe për forcat amerikane të vendosura në Gjirin Persik. (Mearsheimer, 2014:13-14). Megjithatë SHBA-të dhe Arabia Saudite kanë interes që Sirinë ta heqin nga ndikimi iranian, kurse të dy aktorët luftën e shohin në kontekst të ekuilibrit rajonal të fuqisë. (Martini, York, Young, 2013:2).

Me kalimin e kohës dhe me paraqitjen e aktorëve joshitetërorë në luftën civile të Sirisë, lufta mori një drejtim tjetër! Tanimë fokusi primar në çështjen e Sirisë u bë lufta kundër organizatave terroriste, dhe eliminimi i *Daeshit*, ndërsa largimi i Asadit nga pushteti u shndërrua në çështje dytësore.

Ndarja e territorit sirian në linja etnike dhe ideologjike i dha hapësirë aktorëve të ndryshëm joshitetërorë, siç janë: *Njësia për Mbrojtjen Popullore - YPG*, *Forcat Siriane Demokratike - SDF* dhe *Partia e Unionit Demokratik - PYD*, të cilët për Turqinë paraqesin zgjatje të organizatës terroriste PKK në projektimin e një korridori në veri të Sirisë, gjë që për sigurinë turke përbën kërcënim serioz. Operacionet ushtarake të Turqisë⁴ në Siri kishin për qëllim ta largojë *Daeshin* sa më larg vijës kufitare dhe të bllokojë YPG/PKK në vënien e kontrollit mbi linjën lindje-perëndim në veri të Sirisë. (Yeşiltaş, Seren, Özçelik, 2017:9-10).

⁴ Operacioni “Mburoja e Eufratit”, filloi në Gusht të vitit 2016. Ndërsa në deklaratën për shtyp lëshuar nga kryeministrja turke thuhej se ky operacion është në përputhje të plotë me nenin 51 të kreut VII-të, të kartës së OKB-së. Kurse operacioni ushtarak “Dega e Ullirit” filloi në janar të vitit 2018 kundër caqeve të YPG-së, SDF-së, PYD-së dhe DAESH në veriu të Sirisë. Kjo ndërhyrje në bazë të deklaratave të zyrtarëve shtetëror turq korrespondoi me të drejtën ndërkombëtare.

Fakti që mendimi realist argumenton që shtetet shihen si aktorë racional, unitarë dhe që nxiten nga vetëinteresi (*self-interest*) dhe vetëndihma (*self-help*), në vazhdimësi përpiqen ta maksimizojnë sigurinë e tyre. Ky këndvështrim i cili niset gjithnjë nga perspektiva *shtetcentrike*, kur është në pyetje *terrorizmi*, fokusohet kryesisht në luftën kundër terrorizmit (*counter-terrorism*) për hir të mbijetesës së shtetit. (Kürkçü, pa vit botimi: 9). Në këtë rast lëvizjet e Turqisë kundrejt organizatave terroriste në Siri për realistët mund të shihen nga këndi i rritjes së sigurisë dhe interesit nacional.

S'do mend se realizmi është një teori e dobishme për të shpjeguar rrjedhojat e politikës ndërkombëtare, luftën, apo aktorët, dhe atë falë supozimit që shtetet në arenën ndërkombëtare veprojnë në bazë të interesave dhe në sajë të ekuilibrit të fuqisë. Por natyrisht, realizmi nuk është i vetëm në shpjegimin e fenomeneve dhe zhvillimeve globale që ballafaqohet sot komuniteti ndërkombëtar.

KONSTRUKTIVIZMI SOCIAL, SFIDË NDAJ REALIZMIT

Paradigma realiste i kushton vëmendje kryesisht faktorëve material (*nxitjes së fuqisë, interesit nacional etj.*), në raportet ndërmjet shteteve dhe veprimeve të tyre në skenën globale. Fundi i Luftës së Ftohtë prodhoi një konfiguracion debatesh brenda diskursit teorik të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, kësajsoj konstruktivizmi erdhi në shprehje si një frymë e re e cila padyshim se i kontribuon mendimit politik ndërkombëtar⁵.

Mund të thuhet se paradigma konstruktiviste në masë të madhe i detyrohet zhvillimit intelektual në fushën e sociologjisë, mirëpo teoricienët e ndryshëm argumentojnë se njohuritë e teorisë së konstruktivizmit sqarojnë aspekte të ndryshme të zhvillimeve në politikën botërore.

⁵ Paradigma konstruktiviste u lind si rrjedhojë e kundërshtimit ndaj shkollës neorealiste dhe neoliberalë, të cilët kishin një qasje materialiste ndaj politikës botërore. Mirëpo krahas kësaj, edhe pse studiuesit e Marrëdhënieve Ndërkombëtare *realizmin* dhe *konstruktivizmin* e shohin si inkompatibile, Samuel Barkin shpjegon pikat e përbashkëta ndërmjet këtyre dy teorive. Shih: Samuel Barkin "Realist Constructivism: Rethinking International Relations Theory", Cambridge University Press, 2010.

Sipas konstruktivistëve bota sociale dhe politike përfshirë edhe botën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare nuk është entitet fizik ose objekt material jashtë vetëdijes njerëzore. Për ta, sistemi ndërkombëtar nuk është sikurse sistemi diellor, ajo ekziston si një ndërgjegjësım intersubjektiv mes njerëzve në kuptimin që sistemi përbëhet nga idetë dhe jo nga forcat materiale, dhe si i tillë është rregulluar nga njerëz të caktuar në kohë dhe vend të caktuar. (Jackson, Sørensen, 2007: 162).

Teoricieni i parë i cili inkorporoi termin *konstruktivizëm* në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare Nicholas Onuf⁶ pohon se bashkërisht e kemi ndërtuar botën ashtu siç është tani, (Onuf, 2013), ndërsa anarkia në sistemin ndërkombëtar është ajo çfarë shtetet e bëjnë. (Wendt, 1999: 70). Mënyra se si zhvillohet politika ndërkombëtare është e bërë ose e ndërtuar, jo e dhënë, pasi që identitetet dhe interesat janë të ndërtuara dhe të mbështetura nga praktikat intersubjektive. (Zehfuss, 2002: 12).

Perceptimi konstruktivist ndaj *anarkisë* ngrihet mbi argumentimin se ajo është një situatë e imagjinuar që ndërtohet nga aktorët, kurse interesat shtetërore dhe identitetet janë subjekt ndryshimi dhe krijohen gjatë procesit të interaksionit dhe bashkëveprimit. Konstruktivistët konsiderojnë se praktika e sovranitetit ka evoluar me kalimin e kohës, dhe të njëjtin fat e pësoi edhe *fuqia* dhe *identiteti* i shteteve ekzistuese. (Hurd, 2008: 300). Në anën tjetër, Martha Finnemore⁷ kur definon identitetet shtetërore dhe interesat, fokusohet tek normat ndërkombëtare shoqërore dhe mënyra se si këto norma ndikojnë në identitetet dhe interesat e shteteve.

Mendimi politik konstruktivist mëton të sqarojë se mënyrat e veprimit politik perceptohen si rrjedhojë e një situatë të caktuar sociale. (Kıçmari, 2013: 115).

Për konstruktivistët pra, marrëdhëniet ndërmjet shteteve dhe zhvillimet globale nuk janë diç e dhënë por ato janë një konstrukt, proces i vazhdueshëm ndërveprimi, ndërmjet individëve, shteteve, aktorëve joshetërorë dhe normave shoqërore.

⁶ Ndër mendimtarët konstruktivistë mund të radhisim; Friedrich Kratochwill, Martha Finnemore, Peter Katzenstein, Ted Hopf, etj.

⁷ Shih: Martha Finnemore, “*National Interests in International Society*”, Cornell University Press, 1996.

REVOLTA SOCIALE PARARENDËSE E LUFTËS CIVILE

Shpërthimi i protestave dhe revoltës shoqërore që kaploi vende të ndryshme të botës arabe nuk la pa prekur edhe Sirinë. Ashtu sikurse në rajon, po ashtu edhe në Siri, populli kërkoi rënien e sistemit. Kjo revoltë e gjithanshme, në medie, e literaturë u njoh si *Pranvera Arabe*, dhe si e tillë nuk do të kishte mundësi që të ndodh pa ndërveprimin social.

Në të vërtetë mediat dhe rrjetet sociale luajtën një rol të rëndësishëm në veprimet e revoltës së qytetarëve, posaçërisht të të rinjve. Ndërveprimi social i të rinjve në socializimin politik dhe ndikimin në ndërgjegjen e njerëzve u bë një gurthemel në mobilizimin e masave me kërkesën për të ndryshuar regjimet shtypëse dhe autokratike. Rrjedhimisht, bashkëveprimi i njerëzve solli gatishmërinë për të rikonstruktuar identitetin e tyre socio-politik. (Badre, 2014).

Paradigma konstruktiviste në këtë rast supozon se shtetet drejtohen, ose thënë më mirë hartojnë politikat nga identiteti i tyre, i cili ndryshon varësisht situatave të caktuara sociale.

Në rastin sirian, masa e gjerë përmes idesë për të drejtat politike individuale, të drejtat e njeriut, dhe liri synoi ndryshimin strukturor politik dhe vendosjen e identitetit të ri shtetëror. Wendt pohon se ndryshimet strukturore ndodhin atëherë kur aktorët ridefinojnë se kush janë ata dhe çfarë duan. (Wendt, 1999:336).

Ambiciet e protestuesve brutalisht u shtypën nga regjimi i cili *ba'athizmin*⁸ e konsideron si pjesë të identitetit shtetëror sirian⁹. Regjimi gjithashtu konstruktivoi *veten* edhe me identitetin e legjitimitetit -pra pushtetit legjitim- kundër atyre të tjerëve që e luftojnë regjimin, ndërsa për pushtetin lufta në Siri duhet parë si luftë e *shtetit* kundër *terroristëve*. (Şahin, pa vit botimi, 20).

⁸ Partia Ba'ath, është partia dominuese në Siri e cila qeveris me vendin që nga vitet e 60'ta.

⁹ Gjatë konferencës së partisë Ba'ath, i cili zhvilloi punimet në prill të vitit 2017, Asadi ndër tjerash theksoi identitetin shtetëror të Sirisë. Ndërsa sipas tij ajo që ndodh në Siri është "...vazhdim i luftës (historike) mes forcave laike të përfaqësuar nga partia Ba'ath, dhe Islamit Politik." Në lidhje me këtë më gjerësisht shih: Sokrat Al-Alou, "The Arab Socialist Baath Party: Preparing for the Post-War Era", Arab Reform Initiative, 2017, (dorëshkrim).

PARADIGMA KONSTRUKTIVISTE MBI ROLIN E AKTORËVE

Mbrojtësit e shkollës konstruktiviste, involvimin e aktorëve të jashtëm rajonal e global, në skenarin sirian do ta lexonin në kontekst të *identiteteve* dhe *normave* të cilët aktualisht zbatohen në nivel të politikës ndërkombëtare.

Për konstruktivistët ndërveprimi social, sjellja dhe historia ndërmjet aktorëve krijon identitetin¹⁰ për një shtet, ndërsa sipas autorit rus Andrei Tsygankov “identiteti është produkt i garës diskurseve ndërmjet grupeve të ndryshme, ..duke u mbështetur në veprime të ndryshme të Tjetrit”. Në rastin e Ruisë, në përgjithësi Evropa dhe Perëndimi luajti rolin figurativ të *Tjetrit* në debatet rreth identitetit kombëtar. (Tsygankov, 2016: 17-18).

Duke u nis nga ky konstatim ndërveprimi i identitetit kombëtar rus dhe raporteve të tij me Perëndimin është crucial për të kuptuar se si bëhet politika e jashtme e Ruisë. (Postma, 2015:36).

Qëndrimin e Ruisë përballë luftës civile në Siri, konstruktivistët nuk e shohin si rrjedhojë e interesave materiale (ekonomike apo ushtarake), por si rezultat i shqetësimit rus rreth doktrinës perëndimore të pas luftës së ftohtë, pra doktrinës së intervenimit ndërkombëtar kundër regjimeve të padëshiruara (siç ishte rasti në Kosovë, Afganistan, Irak, dhe Libi).

Në këtë kuadër qasja e Ruisë është formësuar nga nevoja për të mbrojtur të drejtën ndërkombëtare që respekton sovranitetin shtetëror dhe parimin e mos-ndërhyrjes në punët e brendshme të shtetit. (Alsaadi, 2017: 87).

Nëse protagonistët e mendimit politik konstruktivist konsiderojnë që politika e jashtme e një shteti determinohet kryesisht nga identiteti i cili është formuar gjatë një rrethane të caktuar historike, dhe se identitetet ideologjike të shteteve mund të llogariten si faktor të rëndësishëm në raportet ndërmjet tyre (Majin, 2016:73-75), atëherë një pikëpamje e tillë sipas konstruktivistëve kur vjen në shprehje antagonizmi Arabi Saudite-Iran reflektohet edhe në skenarin sirian!

Shikuar nga perspektiva e ndryshimit të identitetit, në këtë rast atij shtetëror aktual të Sirisë dhe transformimit të tij drejt një shteti me

¹⁰ Mbi rolin e identitetit dhe normave në nivel të Marrëdhënieve Ndërkombëtare shih: “*The Culture of National Security: Norms and Identity in World Politics*,” nga Peter J Katzenstein, Columbia University Press, 1996.

demokraci, liri, sundim ligji e barazi për të gjithë qytetarët (*Kalin, 2017*), konstruktivistët duke u nis nga ky këndvështrim do ta lexonin qëndrim e Turqisë *vizavi* Sirisë.

Lufta civile siriane- por edhe luftërat të tjera me përmasa të ngjashme si kjo- jep të kuptohet që natyra e tyre është mjaft komplekse që të mund të bëhet objekt studimi i një teorie të vetme, madje edhe më tepër kur bëhet fjalë për një rajon i cili në të kryqëzohen interesat e ndryshme të aktorëve regjional e global. Por, në tragjedi të tilla ajo çfarë është më e rëndësishmja dhe mbi gjitha, është ndalja e luftimeve dhe vendosja e paqes.

KONKLuzion

Zhvillimeve globale në këtë epokë të ndërvarësisë s’do mend se mund që t’iu jepet shpjegim nga këndvështrime të ndryshme teorike brenda kontureve të studimeve të Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Realizmi është shkolla më e vjetër e kësaj disipline, mirëpo konstruktivizmi social, si një kthesë *sociologjike* (McSweeney) e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, jep të kuptohet që kjo shkollë e mendimit politik i shërben tej mase realiteteve të reja politike globale.

Andaj, duke u nis nga ky konstatim, në punimin e mësipërm u shtjellua lufta civile me theks të veçantë ajo siriane si dhe impakti që ajo ka në sistemin e tanishëm ndërkombëtar. Lufta civile në Siri u lind në kontekst të *Pranverës Arabe*, dhe revoltës popullore për ndryshimin e regjimit, por që më pas në të u kyçen aktorë të ndryshëm jo-shtetërore, si edhe aktorët rajonal e global.

Fakti që kjo luftë i tejkaloi kufijtë gjeografik, viteve të fundit u kryen studime në fusha të ndryshme, si në atë të diplomacisë, shkencave politike, studimeve strategjike dhe sigurisë, gjeopolitikës, studimeve të migracionit etj.

Duke marrë parasysh kompleksitetin që ka lufta në fjalë, studuesve të Marrëdhënieve Ndërkombëtare iu pamundësohet shtjellimi i saj vetëm nga këndvështrimi i një paradigme teorike.

Në këtë luftë studiuesit mund që të vërejnë elementin e fuqisë, ose interesit nacional si koncepte bazë të mendimit politik realist, por protagonistët e shkollës konstruktiviste atë mund ta shohin nga këndi i ndërveprimit social si themel i revoltës sociale, ndryshimeve identitare shtetërore, dhe normave të përgjithshme që aktualisht janë prezent në politikën globale.

CONCLUSION

Global developments in this era could surely be explained through different theoretical viewpoints within the framework of international relations studies. Realism is the oldest school of the discipline, however social constructivism as a *sociological* (McSweeney) turn in international relations suggests that this school of political thought serves very well the new global political realities.

On this basis, the paper dealt with civil war with special emphasis on the Syrian War and its impact on the current international system. The civil war in Syria started in the context of the *Arab Spring* and of the popular uprising for regime change. Eventually other participants were locked in the war, as well as regional and global actors.

The fact that this war went beyond its geographic borders has triggered many studies in various fields, such as diplomacy, political studies, strategic and security studies, geopolitics, migration studies, etc.

In regard of the complexity of the war its elaboration solely from the viewpoint of a theoretical paradigm seems an impossible task for international relations scholars.

They might see in this war the element of power or national interest as basic concepts of realistic political thought but on the other hand, adherents of the constructivist school may see it from the viewpoint of social interaction as the basis of social revolt, of state identity changes and of general norms currently present in global politics.

REFERENCES:

ALSAADI, S. (2017). "Russia's Military Involvement in Syria: An Integrated Realist and Constructivist Approach", *International Journal of Law, Humanities & Social Science* Volume 1, Issue 5.

AMARAEGBU, A. D. (2015). "Contextualizing the Syrian Crisis against Realism and Security Competition in the 21st Century", *United Kingdom, Durham University, Centre of Excellence for Scientific & Research Journalism, Coes&Rj Llc*, Volume 4, Number 2.

BADRE, A. (2014). "Deconstructing the "Arab Spring": A Constructivist Analysis", *Cluj-Napoca Romania, University of Babes Bolyai, Faculty of European Studies*. (dorëshkrim).

BOUND, M. (2013). "Syrian Conflict Study", (dorëshkrim).

COLLINS, R. WHITE, D. N. (2011) "International Organizations and the Idea of Autonomy: Institutional Independence in the International Legal Order", Routledge Research in International Law, London, New York, Routledge Taylor & Francis Group.

COVINGTON, R.S. (2015) "The Meaning of Russia's Campaign in Syria", Belfer Center for Science and International Affairs, Harvard Kennedy School.

DUNNE, T. & SCHMIDT, B. (2011). Realism. Në Baylis, J. Smith, S. Owens, P. "The Globalization of World Politics", Fifth Edition, New York, Oxford University Press.

DONNELLY, J. (2005). Realism. Në Burchill, S. Linklater, A. Devetak, R. Donnelly, J. Paterson, M. Smit, R.Ch. True, J. "Theories of International Relations", Third edition, Hampshire, Palgrave Macmillan.

EINSIEDEL, von S. BOSETTI, L. COCKAYNE, J. SALIH, C. Wan, W. (2017). "Civil War Trends and the Changing Nature of Armed Conflict", Tokyo, United Nations University, Centre for Policy Research, UNU-CPR, Occasional Paper 10.

HEYWOOD, A. (2014). "Global Politics", Second Edition, Hampshire, Palgrave Macmillan.

HOOKER, D. R. (2016). "Charting a Course: Strategic Choices for a New Administration", Government Printing Office, Washington, D.C, National Defense University Press.

HURD, I. (2010). Constructivism. Në Smit, R.CH. Duncan, S. "The Oxford Handbook of International Relations", New York, Oxford University Press.

JACKSON, H. R. SØRENSEN, G. (2007) "Introduction to International Relations: Theories and Approaches", Third Edition, New York, Oxford University Press.

KALIN, I. (2017). "Syria: What is next?", Daily Sabah.

KÜRKÇÜ, B. (pa vit botimi). "How to study terrorism: Comparison of constructivism with traditional IR theories", ESAGEV Ekonomik ve Sosyal Düşünce Araştırma Geliştirme Vakfı.

KIÇMARI, S. (2013). "Hyrtje në Diplomaci", Logos-A, Shkup.

MARTINI, J. YORK, E. YOUNG, W. (2013). "Syria as an Arena of Strategic Competition", RAND Corporation.

MAJIN, K. S. (2016). "Iranian and Saudi Cultural and Religious Identities: Constructivist Perspective", Warsaw, The Institute of International Relations, University of Warsaw, Scientific Research Publishing Inc.

MEARSHEIMER, J. (2014) “America Unhinged”, *The National Interest*, Number 129, 9-30.

MORGENTHAU, J. H. (1948). “Politics among nations”, First Edition, New York, Alfred A. Knopf.

ONUF, G. N. (2013). “Making Sense, Making Worlds: Constructivism in Social Theory and International Relations”, New York, Routledge.

POSTMA, J. F. (2015). “Show of Force: Russian Intervention in the Syrian Civil War”, University of Groningen. (dorëshkrim).

REGEHR, E. (2015). “Disarming Conflict”, Ontario, Toronto, Zed Books Ltd.

SCHMIDT, S. (2017). “The Middle East Regional Security Complex and the Syrian civil war”.

STOCKHOLM INTERNATIONAL PEACE RESEARCH INSTITUTE- SIPRI, (2017) “SIPRI Yearbook 2017 Armaments, Disarmament and International Security, Summary”, online ver.: Oxford University Press.

SÖDERLUND, L. (2017) “Russia’s foreign policy, A qualitative case study of Russia’s motives to enter Syria”, Kalmar, Växjö, Linne Universitetet.

ŞAHİN, M. (pa vit botimi). “Syrian dispute in the context of Structural Constructivism”.

THAKUR, R. (2006). “The United Nations, Peace and Security: From Collective Security to the Responsibility to Protect”, Cambridge, Cambridge University Press.

THLEMNÉR, L. (2016). “UCDP/PRIO Armed Conflict Dataset Codebook”, Oslo, Centre for the Study of Civil Wars, Version 4-2016, International Peace Research Institute, Oslo (PRIO).

TSYGANKOV, P. A. (2016) “Russia's Foreign Policy: Change and Continuity in National Identity”, Maryland, Rowman & Littlefield.

WALTZ, N K. (1979). “Theory of International Politics”, USA, Addison-Wesley Publishing Company.

WENDT, A. (1999). “Social Theory of International Politics”, Cambridge, Cambridge University Press.

YEŞİLTAŞ, M. SEREN, M. ÖZÇELİK, N. (2017). “Operation Euphrates Shield Implementation and Lessons Learned”, Istanbul, SETA- Foundation for Political, Economic and Social Research; Turkuvaz Haberleşme ve Yayıncılık A.Ş.

ZEHFUS, M. (2002). “Constructivism in International Relations: The Politics of Reality”, Cambridge, Cambridge University Press.